



Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Prodato Received / Delivery	20.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitua Quantity
SKPM 84UK	8251	2022	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.987/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.987/2022 të datës 10.11.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banir [redacted] kundër organit të punësimit Agjencisë Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.4 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.987/2022 e datës 10.11.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted] lidhur me pretendimet ankimor të ankuesit për heshtje administrative në kërkesën e ankuesit të datës 14.04.2022, 27.05.2022, 12.04.2022 dhe të datës 29.07.2022.

II. Detyrohet Drejtori i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjilan që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh(15) nga data e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 19.08.2022 dhe kërkesën e datës 22.08.2022, si dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, më datë 10.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6993/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit ndaj kërkesave të vazhdueshme të ankuesit, me pretendimin ankimor së mos përgjigja në kërkesat e ankuesit është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë Pyjore të Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 24.11.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6993/2022 të datës 10.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 14.04.2022, 27.04.2022, 12.05.2022, 04.07.2022, 29.07.2022, 19.08.2022 e parashtruar nga ankuesi tek Drejtor i Drejtorisë Koordinuese në Gjilan; Ankesën e datës 05.10.2022 e parashtruar nga ankuesi tek Zv. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës lidhur me mos dhënien e përgjigjes ndaj kërkesave; e-mailin e datës 22.08.2022 dhe datë 30.08.2022 nga ankuesi për Kërkesë për Qasje në Dokumentet Publike e datës 23.08.2022; e-mailin e darës 23.08.2022 nga ankuesi për Deklaratën për mos dhënie të përgjigjes në adresimin e parashtruar e datës 26.09.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 24.11.2022; e-mailin e datës 21.11.2022 nga për e-mailin e datës 17.11.2022 nga për Procesverbalin e datës 04.10.2022; e-mailin e datës 03.10.2022 nga për ankuesin; Akt Emërimit ZP-83/2012 të datës 31.01.2012 për ankuesin.

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së ankuesi është i punësuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe se i njëjti sipas Akt-it të Emërimit me shenjën ZP-83/2012 të datës 31.01.2012 ushtron pozitën *Zyrtar për Çështje Ekonomike* në Drejtorinë Koordinuese Rajonale në Gjilan.

Kolegji i Këshillit bazuar në provat e kësaj çështje ka gjetur së ankuesi në mënyrë të vazhdueshme ka pashtuar kërkesa të personat përgjegjës të njërive përkatëse në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Kosovës dhe atë: me datë 14.04.2022 ka parashtruar kërkesë tek Shefi për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm në Agjencinë Pyjore të Kosovës lidhur me mos qasjen e ankuesit në rrethin-pakon e përbashkët të stafit të AKP-së dhe mos furnizimin me mbushje mujore, më datë 27.04.2022 ka parashtruar kërkesë të Drejtor i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjilan për formimin e një Komisioni për kompletimin e dëshmimeve të OE dhe sistemimin e bollkave të përdorur, më datë 12.05.2022 parashtron kërkesë të Drejtor i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjilan për reflektim përmes një shkresë lidhur me të gjeturat nga shkëputja e marrëdhënies së punës së ankuesit, me rastin e fillimit të punës tutje, më datë 04.07.2022 ka parashtruar kërkesë të Drejtorit i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjilan në lidhje me vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës 6 mujore, më datë 29.07.2022 ka parashtruar kërkesë të Drejtorit i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjilan në lidhje me reflektimin duke vlerësuar rezultatet e punës, më datë 19.08.2022 përmes kërkesë drejtuar Drejtorit të Drejtorisë Koordinuese në Gjilan ka kërkuar miratimin e 2 orëve shtesë për të mbuluar mungesat dhe mos veprimet e duhura për periudhën e shkëputjes nga puna ndërsa me datë 22.08.2022 ka kërkuar lëshimin e një dëshmie të punës reference.

Me tej, sipas shkresat të lëndës rrjedhë së ankuesi më data 05.10.2022 ka parashtruar ankesë të Zëvendësuesi i Kreyshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës për shkak të mos përgjigjes në kërkesat e vazhdueshme të ankuesit.

Kolegji i Këshillit në duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtaret Publik konstaton së çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...". Ndërlidhur më këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktor se: *përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë së i është shkëlur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik.* Përkatësisht sipas këtyre dispozitave ligjore rezulton së çdo nëpunës civil i cili pretendon një veprim administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) të organit gjegjes të punësimit, ka të drejt të parashtror ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht nenit 98 me të cilin është përcaktuar se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj...".* si dhe nenit 127 paragrafi 4 me të cilin parashihet se: *.... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ".* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton së pretendimet ankimore për heshtje administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesat e ankuesit të datës 14.04.2022, 27.05.2022, 12.04.2022 dhe 29.07.2022 janë të palejueshme pasi që ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa, përkitazi me kërkesat e ankuesit të datës 19.08.2022 dhe 22.08.2022, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës nuk ka gjetur dëshmi së Drejtori i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjilan është përgjigjur në kërkesat e ankuesit, kështu që bazuar në nenin 97 paragrafi në Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 1 ku parashihet se: *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ....*, Kolegji vlerëson së Drejtori i Drejtorisë Koordinuese Rajonale në Gjilan duhet të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 19.08.2022 dhe të datës 22.08.2022 dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Përmbledhur si me lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda më numër A.nr.987/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesionale

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Drejtorise Koordinuese Rajonale në Gjilan;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së